



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr .12797/2011

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE PRIZREN, me gjykatesen Vjollca Buzhala e me procesmbajtesen Firdes Santurin ne proceduren kundervajttese kunder te pandehurit Myzafer Kalenderi nga Prizreni , per shkak te kundevajtjes nga neni 16 par.1 p.1 lidhur me nenin 6 dhe nenin 3 te Ligjit nr. 03/L-151, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte public , e ne kuptim te nenit 195 te LMK-se me dt.17.01.2012 mori kete

A K T V E N D I M

I pandehuri Myzafer Kalenderi nga I ati Rahman I lindur me 1960 ne fsh. Kosave tani jeton në Prizren, ne rrugen Enver Dugagjini nr. 37 ,drejtor egzekutim ne spitalin rajonal ne Prizren, me kombesi shqiptar, I martuar baba I kater femijeve, ka te kryer fakultetin ekonomik, I gjendjes se mesme ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse I pandehuri nuk ka bere deklarimin e pasurise ne afatin e regullte ligjor deri me dt. 31.03.2011 , deklarim I cili I obligon te gjithë zyrtaret e larte publik që për pasurinë e tyre të deklarohen regullisht për qdo vit ,sipas kerkeses se AKK – nuk ka permbushur këtë obligimin ligjor mbrenda afatit .

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 16 par.1 p.1 lidhur me nenin 6 dhe nenin 3 te Ligjit nr. 03/L-151, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik se e per kete

D E N O H E T

Me gjobe prej 150 euro /njeqindepesedhjeteeuro /,

I pandehuri obligohet qe gjoben e shqiptuar te paguan ne afat prej 15 dite, nga dita e plotfusqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten do te zevendesohet me denim burgimi duke llogaritur 15 euro me nje dite , poashtu I pandehuri obligohet qe ne afat te lartecekur te paguan 5 euro ne emer te paushallit gjyqesor, nen kercnim te egzekutimit te dhunshem.

A r s y e t I m

Sipas kerkeses se Agjensionit antikorupcion ne Prishtine, me nr. 01-3248/2011 te dt. 12.07.2011 është ngritur procedura kundervajttese kunder te pandehurit Myzafer Kalenderi nga Prirzeni drejtor egzekutiv ne Spitalin rajonal te Prizrenit per shkak te kundervajtjes nga neni I lartecekur ne dispozitiv te aktvendimit.

03-525/2012/02
Suz

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse në Gjykatë në seancën verbale të dt. 17.08.2011 ku I pandehuri e ka mohuar teresisht kundërvajtjen e kryer e cila vihet në baze duke theksuar se me është bere një kerkese për fillimin e procedurës kundërvajtëse nga Agjensija kundërkorrupsion me nr. 1-3248/11 të dt. 15.07.2011 si drejtor egzekutiv në spitalin regjional të Prizrenit, për shkak të mosdeklarimit të pasurisë mirepo një gjë e tillë nuk qëndron pasi që qdo here që nga viti 2007 deri në vitin 2010 kam deklaruar pasurinë, mirepo kam menduar që pasi që gjendja është e njëjte nuk ka nevojë të deklarohet për qdo vit. dua të theksoj se asnjehere nuk kam dashur dhe nuk dua të iki përgjegjësi, mirepo arsye e vetme është ajo se kam menduar se pasi që është deklaruar një here dhe nuk ka ndrysim të pasurisë sime nuk ka nevojë që të lajmërohet.

Andaj Gjykata me qëllim të vertetimit të drejtë të gjendjes faktike në cilësi të deshmitarit mori në pyetje zyrtarin e lartë – të mbikqyrjes së pasurisë në AKK Afrim Atashin I cili pos tjerash theksoj: Është e vertete se Agjensioni antikorrupsion përmes pikave konstatuese ka njoftuar zyrtarët e lartë për obligimin e deklarimit të gjendjes së pasurisë dhe një nder ata persona është edhe zyrtari Myzafer Kalenderi- drejtor egzekutiv në spitalin e Prizrenit, . Agjensioni antikorrupsion ka bere njëfotimin për këtë zyrtar së afati I fundit ligjor për deklarimin e pasurisë është data 31.03.2011 dhe që nga data e marrjes së njoftimit dhe me dt. e parashtrimit të kërkesës personi në fjalë një gjë e tillë nuk e ka bërë, kjo mund të konstatohet se zyrtari I lartë ka qene I njoftuar në baze të listës distribuese që është shpërndarë me dt. 03.03.2011 e të cilën e ka pranuar edhe I njëjti ..

Gjendja faktike e përshkruar me përsefermi si në dispozitiv të këtij aktvendimi është vertetuar përmes deklaratës së të pandehurit, deklaratës së zyrtarit të lartë për antikorrupsion, listës distributive të dt. 03.03.2011 si dhe me administrimin e provave tjera në shkresat e lëndës .

Deklaratën mbrojtëse të të pandehurit se kam menduar se nuk ka nevojë që të lajmërohet edhe njëherë pasi pasuria ime nuk ka kurrfarë ndryshimi Gjykata e ka vlerësuar por të njëjtën e ka hudhur poshte si të pabazuar, nuk ia fali besimin nga se e njëjta ka për qëllim të ik përgjegjësi juridiko kundërvajtëse, besimin ia fali zyrtarit të lartë antikorrupsion Afrim Atashit, të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe e denoi me gjoke me bindje se edhe me këtë lloj denimi do të arihet qëllimi I duhur ndëshkimor, që në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Gjate caktimit të denimit janë vlerësuar rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, pesha e kundërvajtjes të kryer dhe pasojat e saja shkalla e përgjegjësi, rrethanat materijale të pandehurit, e si rrethanë lehtësuese në kuptim të nenit 7 të LMK_ së është marrë ajo se I pandehuri për here të parë është paraqitur në gjykatë për kësolloj të kundërvajtjes, ka bere deklarimin e pasurisë me dt. 14.09.2011 ndihet I panduar, andaj dhe në vend të denimit me burg ia shqiptoi denimin me gjoke me bindje se edhe me një denim të tillë do të arihet qëllimi I deminit që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme

Lartësia e shpenzimeve të procedurës është caktuar në baze të nenit 109 të LMK.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN
Nr.12797/2011
te dt.17.01.2012

Procesmbajtësja
Firdez Santuri

Gjykatësi për kundërvajtje

Vjollca Buzhala

UDHEZIMI JURIDIK : Kunder këtij aktvendimi e në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi mund të ushtrohet ankese Gjykatës së lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj gjykate pa taksa.